




KOMITETI OLIMPIK
KOMBETAR SHQIPTAR

Shtator - Dhjetor 2009

KOKSH

Informacione



Gezuar festat dhe Urimet me te mira per Vitin e Ri 2010
Best season Greetings and wishes of the New Year 2010

Adresa: Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Rr. "Muhamed Gjollësia", Sheshi "Mustafa K. Atatürk" (ish 21-dhjetori), Tiranë-Albania
Tel: +355 4 2235 249 / 2240 602, Fax: +355 4 2240 565,
e-mail: secretariat@nocalbania.org.al
www.nocalbania.org.al

07 Shtator Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv

Me datë 7 Shtator 2009 u zhvillua në zyrat e KOKSH mbledhja e radhës e Komitetit Ekzekutiv, nën drejtimin e Presidentit z. Agim Fagu. Në këtë mbledhje ndërmjet pikave të tjera të rendit të ditës u diskutua mbi organizimin e brendshëm të Komitetit Ekzekutiv dhe komisioneve të KOKSH dhe u mor vendim mbi ngritjen e një Grupi Pune për rishikimin e statutit të KOKSH.

Një pikë tjetër me rëndësi e axhendës ishte pjesëmarrja e Shqipërisë në Lojërat e ardhshme të Iranit, si dhe çështje të tjera të ndryshme të ditës.

10 – 15 Shtator Mbledhje të Komisioneve të KOKSH

Me kërkesë të Presidentit të KOKSH z. Agim Fagu, gjatë një jave intensive pune u zhvilluan mbledhjet e Komisioneve të KOKSH, përkatësisht: Komisioni Teknik, Komisioni i Kualifikimit, Komisioni Sporti për të Gjithë, Komisioni Mjekësor, Komisioni Financë –Marketing, Komisioni Femra dhe Sporti dhe Komisioni i Etikës.

Anëtarët e këtyre Komisioneve parashtruan problematika dhe çështje që kërkojnë vëmendje, si dhe u diskutua për mënyra për ti angazhuar më shumë këto komisione dhe për ta bërë rolin e tyre sa më efikas.



Komisioni Femra dhe Sporti



Komisioni Mjekësor



Komisioni Teknik



Komisioni Sporti për të Gjithë



Komisioni Financë Marketing



Komisioni Kualifikimit

22 Shtator Takim Pune i Akademisë Olimpikë Shqiptare

Anëtarët e Akademisë Olimpikë Shqiptare të kryesuar nga Presidenti i saj z. Arben Kacurri, zhvilluan në zyrat e KOKSH një takim pune me Presidentin e KOKSH z. Agim Fagu. Zoti Fagu shprehu falenderimet për kontributin vullnetar që kjo akademi jep në funksion të zhvillimit të Lëvizjes Olimpikë në Shqipëri, dhe në vecanti kontributin individual me vlerë të çdo anëtari, i cili ka ndihmuar Akademinë Olimpikë Shqiptare që të krijojë fizionominë e saj dhe të orientojë projekte të rëndësishme në funksion të Edukimit Olimpik.

Të gjithë të pranishmit, duke qenë të vetëdijshëm për zbehjen e aktivitetit të AOSH kohët e fundit, shprehën dëshirën dhe vullnetin për ti rikthyer rolin që i takon në Lëvizjen Olimpikë Shqiptare.



9 Tetor Mbledhje e KE

Mbledhja e radhës e Komitetit Ekzekutiv, që u mbajt me datë 9 tetor 2009, ndërmjet pikave të tjera të rendit të ditës ju paraqitën informacione anëtarëve të pranishëm në mbledhje, mbi Kongresin Olimpik; mbi takimet e zhvilluara me Komisionet në KOKSH nga Presidenti Fagu, dhe Pjesëmarrja e Shqipërisë në Lojërat e Vancouverit , 12-28 Shkurt 2010.

13 Nëntor Mbledhje e KE

Me kërkesë të presidentit të KOKSH, z. Agim Fagu u zhvillua mbledhja e radhës e Komitetit Ekzekutiv. Ndër pikat e rendit të ditës që u diskutuan ishin: Informacion mbi takimin me Presidentin e CIO, z. Jacques Rogge, Miratimi i Draftit të Protokoll – Marrëveshjes me Komitetin Olimpik Kombëtar të Rumanisë, Emërime në lidhje me Komisionet dhe zgjedhja e zv. Presidentit të KOKSH, si dhe çështje të tjera të ditës.

Në përfundim mbledhja mori vendime të rëndësishme duke zgjedhur Zv. President të KOKSH , Znj. Ela Tase dhe ra dakort që pranë KOKSH të funksionojnë Komisionet e mëposhtme për të cilët u emëruan dhe Kryetarët përkatës.

Komisioni i Kualifikimit - Znj. Ela Tase; *Komisioni Femra & Sporti* - Znj. Hyrmete Gjetaj; *Komisioni Etikës* - Z.Vojo Malo; *Komisioni Teknik* - Z.Viron Bezhani; *Komisioni Mjekësor* - Z. Muhamet Ostreni; *Komisioni Financ-Marketing* - Z.Flobens Dilaveri; *Komisioni Sporti për të Gjithë* - Znj. Majlinda Pilinci; *Komisioni Kultura & Edukimi* - Z. Gëzim Panariti; *Komisioni Juridik* - Z. Genc Boga.

Secili nga kryetarët e komisioneve do të bëjë propozimet përkatëse në lidhje me anëtarët e komisioneve.



PJESËMARRJE NË AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE

3 – 5 Tetor Kongresi i CIO, Kopenhagen

Presidenti i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar z. Agim Fagu dhe Sekeratri i përgjithshëm z. Stavri Bello morën pjesë në datat 3 – 5 tetor 2009 në takimin më të rëndësishëm të Lëvizjes Olimpike Botërore që u zhvillua në kryeqytetin e Danimarkës, Kopenhagen, Kongresi i 13-të Olimpik, në të cilin morën pjesë të gjitha Komitetet Olimpike Kombëtare, Anëtarë të CIO dhe delegatë të ftuar nga fusha të ndryshme. Presidenti i KOKSH z. Agim Fagu pati një axhendë të ngjeshur me disa takime të veçanta të rezervuara si ato me Presidentin e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (CIO) z. Zhak Rog, Presidentin e Komitetit Olimpik European z. Patrick Hickey, dhe me homologë të tjerë Komiteteve Olimpike Kombëtare, në veçanti me ato të kontinentit European.

9 Tetor Konferencë për shtyp në KOKSH

Presidenti i KOKSH z. Agim Fagu pas pjesëmarrjes në Kongresin e XIII-të Olimpik organizuar nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) dha një konferencë për shtyp për të bërë të ditur mbi atë që u diskutua në këtë kongres dhe në veçanti mbi rekomandimet që dolën nga kongresi.

Kongresi i XIII Olimpik u mbajt nga 3- 5 tetor 2009 në Kopenhagen dhe kryesohej nga Presidenti i Komitetit



Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Jacques Rogge. Misioni i Kongresit të XIII Olimpik ishte shqyrtimi i statusit të Lëvizjes Olimpike në zhvillimet e sotme globale të shoqërisë, mbledhjen e informacionit dhe kërkimi i mendimeve mbi të ardhmen e saj si dhe të japë udhëzime, propozime dhe rekomandime për gjithë pjesëmarrësit dhe aktorë të tjerë të Lëvizjes Olimpike për promovimin e saj dhe zhvillimin harmonik brenda komunitetit. Kongresi u ndoq nga 1249 pjesëmarrës dhe vëzhgues, përfshirë anëtarët e CIO, Presidentët dhe Sekretarët e Përgjithshëm dhe përfaqësues të tjerë të Federatave Ndërkombëtare (IFs) dhe Komitetet Olimpike Kombëtare (NOCs), si edhe përfaqësues të një numri të madh Organizatash Ndërkombëtare, përfaqësues të publikut, vëzhgues dhe media. Kongresi u hap në

prezencën e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve Bashkuara Ban Ki-Moon dhe presidentit të Timorit-Leste, laureat i Çmimit Nobel, José Ramos-Horta.

Kongresi i mbylli punimet duke dalë me një material Rekomandimesh. Gjatë diskutimeve të Kongresit, si rezultat i kontributeve të pjesëmarrësve, u bë e qartë se në shumicën e rasteve, rekomandimet nuk duhet të kufizohen vetëm në një nën-temë por ju kushtua vëmendje më e madhe çështjeve në lidhje me:

- **Marrëdhëniet ndërmjet sportistëve, klubeve, federatave dhe Komiteteve Olimpikë;**
- **Vlerat Olimpikë;**
- **Autonomia e Lëvizjes Olimpikë;**
- **Qeverisja e mirë dhe Etika;**
- **Duke shkuar drejt një shoqërie aktive;**
- **Komunikimi me palët e interesuara në moshën dixhitale, etj.**

Kongresi ftoi Komitetin Olimpik Ndërkombëtar, të gjitha Federatat Ndërkombëtare dhe Komitetet Olimpikë Kombëtare si dhe aktorë të tjerë në sferat e tyre përkatëse të kompetencës, të mësojnë dhe të marrin parasysh Rekomandimet e Kongresit.

Materialin e plotë të përkthyer të Rekomandive të Kongresit të 13-të Olimpikë e gjeni në faqen e Webit të KOKSH në linkun Rekomandime.

30 Tetor Vizitë në Zyrat e CIO të zyrtarëve të KOKSH dhe MTKRS

Presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar Dr. Jacques Rogge i shoqëruar nga Drejtori i Marrëdhënieve me Komitetet Olimpikë Kombëtare z. Pere Miro pritën në një takim pune në selinë e CIO në Lozanë të Zvicrës, delegacionin shqiptar të përbërë nga titullarët më të lartë të institucioneve të sportit Shqiptar, z. Agim Fagu President i KOKSH, z. Ferdinand Xhaferri Ministër i Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve dhe z. Stavri Bello Sekretar i Përgjithshëm i KOKSH.

Fillimisht, Presidenti i CIO uroi z. Fagu dhe z. Xhaferri për detyrat respektive që kanë marrë. Në vijim të takimit Dr. Rogge theksoi se CIO ka ndjekur me shqetësim dhe ka vëzhguar me kujdes atmosferën e krijuar së fundmi në Lëvizjen Olimpikë e Sportive Shqiptare dhe njëkohësisht theksoi rëndësinë e bashkëpunimit si një nga parimet themelore të Olimpizmit. Ndër të tjera në takim u prekën çështje të rëndësishme si ajo e autonomisë së organizatave sportive dhe respekti reciprok në marrëdhëniet e Qeverisë me Komitetin Olimpik Kombëtar.



Nga ana e tij Ministri Xhaferri u shpreh pozitivisht për krijimin e një klime partneriteti dhe bashkëpunimi të MTKRS me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar duke e konsideruar KOKSH si një nga partnerët më të rëndësishëm të Qeverisë në zhvillimin e sportit në Shqipëri apo kontribuesin kryesor në orientimin e politikave zhvilluese sportive në vend. "Prania jonë në këtë takim e konfirmon qartë rëndësinë e këtij partneriteti" u shpreh z. Xhaferri. Takimi u zhvillua në një klimë mjaft konstruktive dhe angazhimi i palëve në takim për të intensifikuar bashkëpunimin dhe për ti shërbyer zhvillimit të sportit në Shqipëri u konsiderua një domosdoshmëri. Nga ana e tij z. Rogge theksoi gadishmërinë e CIO dhe Solidaritetit Olimpik në mbështetjen e Shqipërisë me projekte zhvilluese në ndihmë të sportit shqiptar.

11 – 13 Shtator 2009 Asambleja e III-të e Sportistëve, Moskë

U zhvillua në Moskë në datat 11-13 Shtator Asambleja e III-të e Sportistëve. Në këtë Asamble u votua për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Sportistëve të COE për periudhën 2009 -2012. Qëllimi i këtij Komisioni është të sigurojë që këndvështrimet e sportistëve të merren parasysh në vendimarrjet e COE, si dhe duke qenë një organ këshillues i COE, të veprojë si ndërmjetës midis sportistëve aktivë Europianë dhe Komitetit Ekzekutiv të COE.

Delegati përfaqësues i Shqipërisë në këtë asamble, ishte Anëtari i Komitetit Ekzekutiv të KOKSH, z. Vojo Malo, i cili është ngarkuar me detyrë nga Komiteti Ekzekutiv të ndihmojë me anë të përvojës europiane mirë organizimin e Komisionit të sportistit që do të funksionojë pranë KOKSH.

17 Nëntor Nënshkrimi i Protokoll – Marrëveshjes me NOC Rumani

Presidenti i Komitetit Olimpik Kombëtar të Shqipërisë z. Agim Fagu i shoqëruar nga anëtarët e Komitetit Ekzekutiv znj. Hyrmete Gjeta dhe z. Viron Bezhani, kanë zhvilluar një vizitë pune në Rumani ku janë takuar me Presidentin e Komiteti Olimpik dhe Sporteve të Rumanisë, z.Oktavian Morariu dhe z. Joan Dobrescu, Sekretar i Përgjithshëm. Takimi u zhvillua ditën e martë, 17 nëntor 2009 në Kompleksin Olimpik “Sidnei 2000” në Izvorani. Qëllimi i kësaj vizite ishte nënshkrimi i një Protokoll Marrëveshje të bashkëpunimit dypalësh mes dy Komiteteve Olimpikë Kombëtare. Protokollin përfshin shkëmbimin e përvojës në sport me interes të përbashkët, në nivelin e trajnerëve të disiplinave të ndryshme sportive, në shkencat sportive dhe mjekësisë sportive, si dhe shkëmbimet midis dy Akademive Olimpikë, të Rumanisë dhe Shqipërisë. Ky protokoll marrëveshje është i vlefshëm deri në Dhjetor 2013, me mundësinë për t’u zgjatuar.



PAKETA OLIMPIKE

Muaji Shtator Seminare dhe Shpërndarja e Paketës Olimpikë

Muaji Shtator ka qenë intensive dhe impenjues për stafin e KOKSH me udhëtime nëpër rrethe të ndryshme të Shqipërisë me qëllim organizimin e Seminareve dhe shpërndarjen e Paketës Olimpikë nëpër shkolla dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale. Kështu u zhvilluan takime në Kukës, Pogradec, Korçë, Berat, Shkodër e Vlorë, me mësues të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore Rajonale përkatëse. Të gjitha palët shprehën entuziazëm për prezantimin e kësaj Pakete Olimpikë dhe procesin e edukimit olimpik në shkollat e tyre, si dhe paraqitën interes dhe projekte për mbajtjen e Ditës Olimpikë në rrethet e tyre. Pjesë e këtyre takimeve ishte shpërndarja e praktikave të qyteteve të tjera për organizimin e Ditës Olimpikë me anë të video dhe foto të ndryshme. Paketa Olimpikë u shoqërua dhe me shpërndarjen e materialeve të tjera publikime të KOKSH për të cilat u vu re gjithashtu një interes i madh i pjesëmarrësve.



Korçë



Vlorë



Shkodër



Kukës



Pogradec



Berat

22 -25 Tetor

Kampionati Botëror i Xhudos Junior, Paris

Nga data 22-25 Tetor 2009 në Paris, Francë u zhvillua Kampionati Botëror i Xhudos për të rinj. Federata Shqiptare e Xhudos mori pjesë me një sportiste femër, Aurora Shkoza, e cila u skualifikua në turin e parë. Ndërsa sportistja Majlinda Kelmendi e cila konkurroi në kategorinë 52 kg u shpall Kampionë Bote.

Me anë të një marrëveshjeje ndërmjet Federatës Botërore, Federatës Shqiptare dhe asaj Kosovare, Federata Botërore ka krijuar një status të vecantë dhe provizor për sportistët e Kosovës, në mënyrë që ata të konkurrojnë nën Flamurin e Federatës Ndërkombëtare të Xhudos. Është për tu vënë në dukje fakti që sportistja Majlinda Kelmendi u lejua të përfaqësojë Kosovën në këtë veprimtari.

Forma e shkëlqyer sportive e kësaj sportisteje premtan për rezultate të mëtejshme elitare në aktivitete të tjera.

Sportistja Majlinda Kelmendi u prit në zyrat e KOKSH nga Sekretari i Përgjithshëm duke u përgëzuar për rezultatet e arritura. Sportistja shoqërohej në këtë takim nga Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Xhudos Labo Capo dhe trajneri i saj Driton Kuka.



28 Tetor

Seminar “Rritja e efektivitetit në manaxhimin e klubeve sportive”

Në datë 28 Tetor 2009 Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar organizoi seminari n me drejtuesit e Klubeve Sportive të vendit në bashkëpunim me Shoqatën e Klubeve Sportive dhe Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi” me temë: “Rritja e efektivitetit në manaxhimin e klubeve sportive”.I zhvilluar në ambjentet e reja të Bibliotekës se re pranë AEFS, me praninë e drejtuesve të 12 klubeve shumësportëshe të vendit (Burrelit, Tiranës, Laçit, Teutës, Korçës, Beratit, Gramshit, Vlorës, Shkodrës, Përmetit, Kavajës), specialistë pranë MTKRS dhe pedagogë të AEFS, seminarin e përshëndeti Presidenti i KOKSH z. Agim Fagu dhe Rektori i AEFS z.Vejsel Rizvanolli. Në seminar u trajtuan tema të ndryshme mbi menaxhimin me efektivitet të organizatave sportive si dhe Rekomandimet e dala nga Kongresi i 13 Olimpik Botëror. Organizimi i këtij seminari u mirëprit nga pjesëmarrësit duke theksuar që takimi, shkëmbimi i ideve dhe eksperiencave me njëri-tjetrin, si dhe njohja me orientimet bashkëkohore të sportit në botë janë të vlefshme.



20 Nëntor

Krosi Olimpik i Vjeshtës – Luz i Vogël

Përcjellja e frymës Olimpike është realizuar këtë radhë me anë të një tjetri projekt të KOKSH në Luz të Vogël të Kavajës, ku në bashkëpunim me Drejtorinë Arimore të qytetit është zhvilluar këto ditë krosi masiv , me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave të këtij fshati. Në këtë takim kishte dhe përfaqësues të pushtetit vendor.



17 – 20 Shtator Forumi ENSSEE Ragusa

U zhvilluan në Ragusa, Sicili, në datat 17 -20 Shtator Forumin e 10-të bianual me temë “ Praktika më e mirë në sport, Edukimi nga struktura në veprim” nga Scuola dello Sport Sicilia në bashkëpunim me ENSSEE (Rrjeti Europian për Edukimin dhe Punësimin në Shkencat Sportive). Në këtë sesion mbajtën fjalën lektorë të njohur të lëvizjes Olimpikë si prof. Jean Kamy dhe Karsten Froberg, ish Presidentë të ENSSEE. Në këtë forum mori pjesë z. Artan Pogoni, Petagog në Akademinë e Edukimit Sportiv e Fizik, “Vojo Kushi”, i propozuar nga Rektorati i këtij Instituti.

10 Tetor 90 vjetori i NOC Polak

Presidenti i KOKSH z. Agim Fagu ishte i ftuar nga Komiteti Olimpik Polak në 90-vjetorin e krijimit të tij. Në ceremonitë festive që u zhvilluan në Varshavë në datat 11-12 Tetor, z. Fagu, së bashku me personalitete të tjera të Komitetit Olimpik Polak, Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe Qeverisë Polake, morën pjesë në pritjen Gala që u zhvillua në Qendrën Olimpikë, në inagurimin e Ekspozitës “Pierre de Cubertin dhe Arti”, vizitë në muzeun e Sportit dhe Turizmit në Qendrën Olimpikë, si dhe u pritën nga Kryeministri Polak.

12 – 16 Tetor Kursi Rajonal i Mjekësisë Sportive CIO, Antalya

Komiteti Olimpik Kombëtar Turk në bashkëpunim me Komisionin Mjekësor dhe Anti-Doping organizun në Antalya, në datat 12-16 Tetor Kursin Rajonal të Mjekësisë Sportive, me pjesëmarrje të mjekëve sportivë, fizioterapistëve sportivë dhe shkencëtarëve sportivë. Në seminar u trajtuan tema të ndryshme mbi teknologjitë e reja të mjekësisë sportive dhe historinë e doping dhe aktivitete anti-doping.

27 - 28 Nëntor Asambleja e 38 - të e Përgjithshme e COE

49 Komitetet Olimpikë Europiane u takuan në Lisbonë në datat 27-28 nëntor, nën drejtimin e presidentit të COE z. Patrick Hickey, për të hartuar planin për 4 vitet e ardhshëm. E hapur në prezencën e Presidentit të CIO z. Jacques Rogge, Jose Vicente Moura- President i Komitetit Olimpik Portugez, Laurentino Dias-Sekretar i Shtetit për Rininë dhe Sportin, si dhe autoriteteve të shumta sportive portugeze, Asambleja e Përgjithshme Vjetore e COE bëri një përmbledhje të aktiviteteve të së kaluarës dhe gjithashtu zgjodhi Komitetin e ri Ekzekutiv për vitet 2009-2013. Presidenti, Zëvendës-Presidenti, Sekretari Përgjithshëm dhe Mbajtësi i Thesarit u rizgjodhën, ndërsa në bordin e anëtarëve pati disa ndryshime. Të 240 pjesëmarrësit europianë gjatë qëndrimit të tyre të shkurtët ishin të ftuar nderi në festimet e 100-vjetorit të themelimit të Komitetit Olimpik Portugez.

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqipëtar falenderon Kompaninë Coca Cola Bottling Shqipëria për bashkëpunimin e rëndësishëm dhe të sukseshëm që kemi pasur gjatë vitit 2009. Ky bashkëpunim ka siguruar mbështetje



në një sërë projekte të KOKSH nëpërmjet furnizimeve me produkte të Coca Colës të cilat i kanë dhënë jetë dhe kanë gëzuar sidomos fëmijët pjesëmarrës në këto aktivitete.



Urime më të mira për festat të fundvitit CCBSh dhe suksese të tjera për vitin 2010!

6 Nëntor Dita Olimpike Kukës

Në datën 6 Nëntor 2009, në qytetin e Kukësit u zhvillua Dita Olimpike "Kukës 2009".

E organizuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale Kukës në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Fëmijëve të rrethit, mbështetur nga Bashkia Kukës dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Dita Olimpike "Kukës 2009" ishte një festë e vërtetë e qytetit.

Pishtari Olimpik kaloi nëpër rrugët e qytetit duke u mbajtur nga sportistë të moshave të ndryshme për të ardhur tek i fundit që ishte sportisti i njohur kampion kombëtar në mundje z. Lutfi Mece i cili e solli pishtarin në Sheshin Skënderbej përpara Bashkisë dhe duke anunçuar çeljen e Ditës Olimpike. Në këtë aktivitet morën pjesë 4 shkollat 9-vjeçare: "Avni Rustemi", "Lidhja e Prizrenit", "Bajram Curri" dhe "Riza Spahiu". Programi ishte i larmishëm jo vetëm me veprimtari sportive por edhe lojëra dhe këngë për fëmijë. Nxënësit konkuruan sipas programit sportiv në gara të ndryshme si aerobi, volejball, basketboll, mundje e lirë, futboll, akrobaci, lojëra popullore, tërheqje litari, ping pong, gara me biçikleta, vrapim, gara stafete, etj. Aktiviteti u përshëndet dhe ndoq nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme: z. Viron Bezhani-përfaqësues i KOKSH, z. Ibsen Elezi-Drejtor i DAR Kukës, z. Hasan Halilaj-Kryetar i Bashkisë, z. Hajri Ademi-Kryetar i Këshillit të Qarkut dhe znj. Melita Omuri-Drejtoreshë e QKF.

